

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: “AMBIENTI” SHPK me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	26.12.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **22.12.2023**, në Ora: **20:36 h**, nga Operatori Ekonomik: **“AMBIENTI” SHPK**, me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-12928-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-076-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e jashtë afatshme Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **“AMBIENTI” SHPK**, me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-12928-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-076-2-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e mëtejshëm për këtë aktivitetin të prokurimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: “AMBIENTI” SHPK. me adresë në **Prishtinë**, si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, me datë: **22.12.2023**, në Ora: **20:36 h**

Shih tabelën nëpërmjet sistemit te e-prokurimit:

1. Kërkesat për rishqyrtim				
Data e dërgimit	Ofertuesi	Përshkrimi	Statusi kërkesës	Afati i fundit për vendim
22.12.2023 20:36	" AMBIENTI " SH.P.K.	Kërkes per ri-shqyrtim	Paraqitur	Detajet

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Operatori Ekonomik: “AMBIENTI” SHPK. me adresë në **Prishtinë**, ka bërë kërkesë për rishqyrtim përmes e-prokurimit me datë: **22.12.2023**, në Ora: **20:36 h**

Në bazë të paragrafin 1 të nenit 5 të LPP-së , **Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune.** Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit., Në bazë të nenit të lartpërmendur **Kalkulimi i afatit kohorë të kërkesës së parashtruar për ri-shqyrtim nga ana juaj fillon së numëruari nga dita e sotme. Ndërsa në bazë të nenit 60 paragrafi 1 pika a e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik e cila përcakton si në vijim:**

“Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se e njëjta duhet te parashtrohet së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)” .

Me qenë se për Aktivitetin e Prokurimit **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-12928-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-076-2-1-1**, hapja e tenderëve apo data e fundit për dorëzim të ofertave është parapara data: **29.12.2023 në 13:00 h**, Autoriteti Kontraktues vjen në përfundim se **ju si Operator Ekonomik kërkesën për ri-shqyrtim e keni parashtruar në kundërshtim me të nenit 60 paragrafi 1 pika a e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, pra jashtë afatit kohorë të përcaktuar me legjislacionit e prokurimit publik dhe si e tillë nuk mund të shqyrtohet.**

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit